



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА  
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT  
STATE AUDIT OFFICE

## Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

**Subjekti:** ISHP Institut i Universitetit  
për tomografi me emision positron

### Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare dhe revizioni i pajtueshmërisë për vitin 2020 – llogaria për mjetet nga Fondi(737)

**Qëllimi i revizionit:** Për të marrë bindje të arsyeshëme nëse raportet financiare janë të liruara nga paraqitjet e gabuara materialisht dhe nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet që reflektojnë në raportet financiare janë në të gjitha aspektet materiale në pajtim me rregullativën ligjore përkatëse, udhëzimet dhe politikat e vendosura.

### Gjendjet kyçë të konstatuara:

- e drejta e pa transferuar e përdorimit të përhershëm të objektit ndërtimor;
- harmonizimi i pa kryer i evidentimit të kontabilitetit dhe të materialeve;
- evidentimi i paazhurnuar i stokut në evidentimin e kontabilistikës dhe
- evidentimi i pa azhurnuar i detyrimeve.

### Mendimi i dhënë\*:

Është shprehur mendim me rezervë në lidhje me të vërtetën dhe objektivitetin e raporteve financiare dhe përpajtueshmërinë e transaksioneve financiare me rregullativën ligjore relevante për vitin 2020.

### Dobësítë kyçë të sistemit:

Është i nevojshëm rregullimi i Ligjit për Prokurimet Publike në drejtim të kufizimit të marzhit të shitjeve dhe sigurimit të shërbimeve për servisim dhe pjesë rezerve me çmime që korrespondojnë me tregun, me qëllim që të sigurohet zbatimi i duhur i parimit të ekonomizimit, efikasitetit dhe efektivitetit të përdorimit të mjeteve publike.

Pavarësisht ekzistimit të detyrimit ligjor të Ministrisë së Shëndetësisë për vendosjen e sistemit kombëtar për punën e kontabilistikës dhe materialo-financiare në ISHP dhe sistem qendror për regjistrimin e orarit të punës për nevojat e ISHP-së, të njëjtë nuk janë në funksion.

### Rekomandimet kyçë:

- pas marrjes në shfrytëzim të përhershëm të pronës së patundshmërisë, regjistrimit në kadastër të patundshmërive dhe evidentimi përkatës në librat afariste;
- zbatimi i regjistrimit që do të sigurojë harmonizimin e kontabilitetit me gjendjen faktike të mjeteve dhe detyrimeve;
- evidentimi i azhurnuar dhe kronologjik i transaksioneve në librat afariste në momentin e kryerjes së tyre.

### Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Nuk janë marrë vërejtje mbi draft-raportin e revizorit e autorizuar shtetëror.

● pozitive, ● me rezervë ● të pavolitshëm, ● ë përmblajtur